



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
REKTORATI

Nr. 1764/14 Prot.

Tiranë, më 26.10.2020

UDHËZIM
Nr. 4 datë 26.10.2020

PËR
APLIKIMIN DHE REGJISTRIMIN E KANDIDATËVE NË KUOTAT E PAPLOTËSUARA SIPAS
PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË, RAUNDI IV, NË UNIVERSITETIN E
MJEKËSISË, TIRANË, VITI AKADEMIK 2020-2021

Në zbatim të Ligjit nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në RSH", Udhëzimit nr. 10, datë 25.05.2019 "Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në programet e ciklit të parë të studimeve si dhe në programet e integruara të ciklit të dytë, në Institucionet e Arsimit të Lartë për vitin akademik 2019-2020" të MASR, i ndryshuar, për procesin e aplikimit dhe regjistrimit në kuadër të plotësimit e kuotave të mbetura bosh, sipas programeve të studimit, Raundi IV,

UDHËZOJ:

1. Kandidatët që kanë aplikuar në raundin e tretë në programin përkatës të studimit të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, të cilët nuk kanë qenë fitues dhe nuk janë të regjistruar në një program tjetër, të paraqesin pranë sekretarive mësimore të fakultetit përkatës kërkesën me shkrim për regjistrim në atë program studimit (sipas modelit të shtojcës nr. 1, bashkëlidhur këtij udhëzimi), në datat **28-29 Tetor 2020**, nga ora **8:00** deri në **14:00**.
2. Fakultetet brenda datës **29 Tetor**, ora **16.00** përcjellin në Rektorat listat e kandidatëve sipas renditjes. Publikimi i listave bëhet më datë 29.10.2020 në mjediset dhe faqen zyrtare të njësisë kryesore dhe të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë.
3. Me datat **30-31 Tetor 2020**, bëhet regjistrimi i kandidatëve sipas renditjes të shpallur sipas pikës 2, pranë fakulteteve në përputhje me kuotat e mbetura bosh, si më poshtë:

Data 30 tetor 2020

Faza I – ora 9.⁰⁰-11.⁰⁰
Faza II – ora 11.⁰¹-13.⁰⁰
Faza III- ora 13.⁰¹-15.⁰⁰

Data 31 tetor 2020

Faza I – ora 9.⁰⁰-11.⁰⁰
Faza II – ora 11.⁰¹-13.⁰⁰
Faza III- ora 13.⁰¹-15.⁰⁰

4. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen njësitë kryesore të UMT-së dhe sekretaritetë mësimore.



Shtojca nr. 1

**FORMULAR KËRKESE
RAUNDI IV**

Unë i nënshkruari _____, ID e maturës _____, aplikant i Raundit III në programin _____, paraqes kërkesën time për të vijuar konkurrimin në këtë program.

- Deklaroj se nuk jam regjistruar në asnjë program studimi.
- Jam informuar nëpërmjet faqes zyrtare të fakultetit dhe universitetit, për Udhëzimin nr. 4, datë 26.10.2020 “Për aplikimin dhe regjistrimin e kandidatëve në kuotat e paplotësuara...” të Rektorit të UMT, lidhur me publikimin e renditjes dhe fazat e regjistrimit të kandidatëve.

Emër

Atësi

Mbiemër

Nr. telefoni: